



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA




Kryetarja e Komunës  
01nr 112-16173  
Dt: 25.03.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 dhe nenit 102.1 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për formimin e Komisionit profesional për vlerësimin e raportit të lejes mjedisore komunale, me dt. 25.03.2016 e miraton këtë:

V E N D I M


1. Revokohet në tërësi vendimi i Kryetares së Komunës së Gjakovës 01 Nr. 112-2531 i dt. 20.03.2014, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për formimin e Komisionit profesional për vlerësimin e raportit të lejes mjedisore komunale.
2. Ky vendim revokohet për shkak të Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ka nxjerr udhëzimin e ri Administrativ Nr. 17/2015 ku kanë ndryshuar disa procedura për dhënien e lejes mjedisore komunale.
3. Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
  - Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
  - Drejtorisë për Shërbime Publike
  - Drejtorisë për punë Inspektuese

Kryetarja e Komunës,  
Znj. Mimoza Kusari-Lila





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA GJAKOVË  
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Për:	<b>Kryetaren e Komunës, znj. Mimoza Kusari Lila</b>
Datë :	<b>19.01.2016</b>
Numër :	<b>07/zyrtar</b>
CC :	<b>Zyrës Ligjore</b>
Nga:	<b>Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Fatos Deda, bashk. prof.për mjedis</b>
Përmes :	<b>U.D. të Drejtorit të Drejtorisë, znj. Elida Bejtullahu I.D.A.</b>
Lënda:	<b>Kërkesë</b>



E nderuar,

Bazuar në obligimet e dalura nga Udhëzimi Administrativ nr. 10/2012 për dhënjen e Lejes Mjedisore Komunale, ju keni caktuar Komisionin Profesional për vlerësimin e Raporteve të Lejeve Mjedisore Komunale me Vendim 01nr. 112-2531 të datës 20.03.2014, konform obligimeve nga nenit 9 i U.A.

Komisioni ka qenë në këtë përbërje :

Fatos Deda, kryesues

Riza Morina, anëtar

Ilhamije Kumnova, anëtare

Elida Bejtullahu, anëtare

Afrim Ademi, anëtar.

Meqë ky U.A. është shfuqizuar nga ana e Ministrit të MMPH, dhe Ministria ka miratuar Udhëzimin Administrativ të ri me Nr. 17/2015 të dates 01.12.2015, tanimë kanë ndryshuar edhe disa procedura për dhënjen e Lejes Mjedisore Komunale.

Ndër të tjera, në nenin 8 të U.A. decidivisht thuhet se “ Për shqyrtimin dhe vlerësimin e Raportit të LMK, Drejtori i Drejtorisë përkatëse komunale, formon Komisionin Profesional”.

Andaj si rezultat, kërkojmë nga Ju që të shfuqizoni Vendimin e lartëcekur dhe të shkarkoni nga përgjegjësitë Komisionin e deritashëm, në mënyrë që Drejtori I DUMM të mund të filloi me ushtrimin e obligimeve të ngarkuara me U.A. në fjalë.

Me respekt,

KOMUNA GJAKOVË

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereze (objekti i ish BVI), Gjakovë, Republika e Kosovës

Tel: +381 390 322452, 320070, 325059.

www.gjakova-komuna.org